

Gjuhë të tjera : skanoni kodin QR me celularin
tuaj.
www.vd.ch/orientation
► rubrika *Publications*



Lozanë, mars 2024

Zonjë, Zotëri, të dashur Prindër,

Verën e ardhshme, fëmija juaj mbaron shkollën dhe mund të fillojë një formim profesional, të hyjë në gjimnaz apo në një klasë rakordimi. Zyra kantonale e orientimit shkollor e profesional (OCOSP) është krah jush në këtë moment të rëndësishëm. Me anën e kësaj letre, ne ju informojmë se mund t'ju ndihmojmë në dy mënyra: duke ju vënë në dispozicion mjete informuese dhe një shërbim këshillues në fushën e orientimit.

1. Doni ta shoqëroni fëmijën në realizimin e projektit të tij ?

Ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj duke vizituar sitin tonë në internet :

www.vd.ch/orientation

► rubrika ***Pour les élèves de la scolarité
obligatoire***



Atje do të gjeni informacione mbi :

- profesionet, formimet dhe perfeksionimet ;
- kërkimin dhe zhvillimin e stazheve ;
- kërkimin e një vend formimi.

2. Dëshironi të diskutoni për projektin e fëmijës suaj me një specialist/e ?

Ju mund të vini bashkë me fëmijën të diskutoni me këshilltaren apo këshilltarin e shkollës, për :

- të identifikuar interesat, vlerat, kompetencat dhe burimet e fëmijës dhe për të parë nëse ato përkojnë me formimet e mundshme ;
- t'i ofruar fëmijës një mbështetje të personalizuar në realizimin e projektit të tij (kërkimin e ndërmarrjeve, krijimin e dosjes së kandidaturës, përgatitjen për provimet e pranimit, etj.) ;
- të punuar lidhur me vështirësitë dhe pengesat që fëmija mund të hasë në realizimin e projektit të tij profesional.

Duke qëndruar në dispozicionin tuaj, ne ju drejtojmë, Zonjë, Zotëri, të dashur Prindër, përshëndetjet tona më të mira.

Alexandra Petrovitch

Drejtoresha